

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “FV Gjelberimi ne Qytet”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi
03452000-3- **Pemë**

VLERA E FONDIT LIMIT: 29.160.620 (Njëzetë e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.

Argumentim:

- **Përlllogaritja e vlerës së fondit limit :**

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT
TË KONTRATËS SË PROKURIMIT ME TITULL:

“F.V Gjelbërimi në qytet ”

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr. 70 prot, nr.14, date 05.01.2023 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkise Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përlllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: FV. Gjelberim ne qytet”.

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, si dhe neni 42 sipas të cilit:

“Në Përlllogaritjen e Vlerës Limit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë parasysh;

Çmimet e botuara nga INSTAT- i ose/dhe çmime të tjera zyrtare të njohura nga institucionet përkatëse si psh., nga Organet Tatimore apo Doganore, Dhoma e Tregtisë, në Manuale etj, ose /dhe çmimet e Tregut; ose/ dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga Autoritete të Tjera Kontraktore dhe /ose çmime ndërkombëtare të publikuara

Komisioni organizoi punën për Kërkimin dhe Grumbullimin e Informacionit mbi Çmimet Orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

- 1. Listat e publikuara** nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
- 2. Institucione të tjera zyrtare** të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.

Grupi u mbeshtet: Në studimin e tregut vendas, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e disa subjekteve vendas.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Grupi i punës u konsultua respektivisht me operatore ekonomike që operojnë në fushën e objektit të prokurimit.

Në mbeshtetje të nenit 76, pika 1, germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- 1. Komisioni organizoi punën** për Kërkimin dhe Grumbullimin e Informacionit mbi Çmimet Orientuese në Treg për të gjithë elementet e kostos së mallrave objekt i këtij prokurimi;
- 2. Komisioni mori në konsiderat çmimet e subjekteve që afruan ofertat**
- 3. Në hetimin e tregut vendas,** nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e kompanive, sipas së cilës ato duhet të jenë të specializuara në përputhje me kërkesat tona specifike të shprehura në projekt si dhe me autoritet në treg,

Garancia e mallit sipas specifikimeve teknike.

Afatet e lëvrimet: 30 ditë.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 29'000'000 Lek

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe mbështetet në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Shërben për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, me qëllim për të parë aftësitë financiare të operatorëve ekonomikë

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore për vitin 2021, ligjin nr.131/2015 “Për Qendren Kombëtare të Biznesit” neni 3.1(a,b,c). Dokumentat e kërkuara me siper, do të paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhenies së kontratës ose nëse kerkohen sqarime nga A.K.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 11’600’000 lekë

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 40, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme _____ të lëshuar nga _____ (shënim- përcaktoni, **nëse parashikohet** nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe _____.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Licensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P-12 B (Punime të inxhinierisë së mjedisit).

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria NP - 12 B “Punime të inxhinierisë mjedisore”: Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv për mbjelljen e drurëve dekorativ referuar vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

2.3.4 Licence lidhur me ekzekutimin e punimeve sipas modelit të Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, menaxhimit të mjedisit për një zhvillim të qëndrueshëm është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me

standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. (në përputhje me klauzolat e ligjit 10431 datë 09.06.2011 për mbrojtjen e mjedisit i ndryshuar”, me qëllim marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e mjedisit).

3.2.4 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

a. Një punësim mesatar i të paktën **20** punonjës (duke përfshire stafin tekniko – menaxherial), për periudhën Nentor 2022 – Janar 2023, e dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga Administrata Tatimore si dhe sipas vendimit nr. 742, datë 06.11.2003.

b. Bashkëlidhur listëpagesa e cdo muaji të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numër E-SIG 025/a.1) për periudhën Nentor 2022 – Janar 2023.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e mallit objekt kontrate që kërkohet të furnizohet dhe vendoset, grafiku i lëvrimin dhe kualifikimi i punonjësve (element shumë i rëndësishëm lidhur me njohuritë e tyre specifike në furnizimin dhe vendosjen drurve dekorativ), dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve, kualifikimi i tyre, grafiku i lëvrimin dhe natyra e mallit objekt prokurimi, me kohështirje Nentor 2022 – Janar 2023, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 20 punonjës, është në përputhje me volumin e punës, natyrën ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- a) Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën Nentor 2022– Janar 2023:
- 1 (një) Agronom te shoqëruar me diplomë, cv, kontrate pune, dhe te jete i pajisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit.
 - 1 (një) inxhinier Pyjesh i shoqëruar me diplome, cv, kontrate pune.
 - 1 (një) inxhinier Mjedisi i shoqëruar me diplome, cv, kontrate pune dhe te jete i pajisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit.
 - 1 (një) Automakinist, i shoqëruar me kontrate pune, dëshminë e aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT .
 - 1 (një) Eskavatorist i shoqëruar kontrate pune, dëshminë e aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT.
 - 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”punime në sipërfaqe gjelberta” që vërtetohen me çertifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj, te shoqëruar me kontrate pune.
 - 10 (dhjetë) punëtorë të thjeshtë, te shoqëruar me kontrate pune.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe natyrën e mallit që kërkohet të furnizohet. Nevoja për 1 agronom, 1 inxhinier mjedisi, 1 inxhinier pyjesh, 1 automakinist, 1 eskavatorist, 5 punonjës të kualifikuar për punime në sipërfaqe te gjelberta, dhe 10 punëtorë të thjeshtë, është e lidhur ngushtësisht me natyrën dhe artikujt objekt kontrate. Mungesa e këtij stafi potencialisht mund të çojë në dështimin e kontratës së furnizimit, ose në rastin më pak të keq do të rezultojë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe furnizimin e mallit me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor teknik është minimal dhe është përcaktuar në raport të ngushtë me natyrën specifike të mallit objekt kontrate.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, nenit 77 pika 4 te LPP si dhe bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës në fjalë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në*

shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat :

a) Operatori ekonomik duhet paraqesë Certificate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certificate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative).

ose

Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certificate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certificate origjine të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative).

Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë furnizimi nga subjekti importues, ku të jetë pajisur me këto dokumenta:

- Certifikatë Origjine nga shteti importues.
- Certificate Fitosanitare nga shteti importues.
- Varietetet të jenë të regjistruara në katalogun kombëtar shqipëtar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 ” *Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor*”, dhe VKM nr. 523, datë 13.07.2016 ” *Për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese*”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe bazuar në aktin nënligjor normativ të nxjerrë në bazë të Ligjit 10416, ku në pikën II, ”**KËRKESAT PËR TREGTIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE**”, gërma ”d” të VKM 523 përcaktohet se: ”1. *Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi*”.

b) Operatori ekonomik duhet paraqese Çertifikaten e Regjistrimit per torfen dhe plehun te leshuar nga Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

c) Çertifikatat ISO:

1. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
2. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 / ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
3. Çertifikatën e sigurisë së trafikut rrugor ISO 39001 -2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto çertifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave

të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhëngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.6 Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Pronesia
Mineskavator	1 copë	pronesi ose qera
Kamion me vinc	1 copë	pronesi ose qera
Kamioncine me mase maksimale te autorizuar deri 3.5 ton	2 copë	pronesi ose qera
Kamioncine me vinc	1 copë	pronesi ose qera
Makineri per shkulje pemesh ekzistuese me thika	1 copë	pronesi ose qera
Makineri per Hidrombjelljen e barit	1 copë	pronesi ose qera
Makineri me tryele per hapje gropash	1 copë	pronesi ose qera
Pirun (per levizjen e drurëve dekorativ)	1 copë	pronesi ose qera

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Certifikata e Kontrollit Teknik, Certifikata e transportit të malrrave/Liçencë, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i mjeteve ne pronesi / qira / kontrate furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambinetin ku do të mbjellen/vendosen sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.5. Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: “..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e meposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks	052 22 23 10
E-mail	info@durres.gov.al
Ueb-faqe	www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, Mall

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-62964-03-20-2023

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “FV Gjelberimi ne Qytet”

5. Fondi limit: 29.160.620 (Njëzetë e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 30 ditë

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 05.04.2023 Ora: 10:00

Njësia e Prokurimit